

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: *Ndërmarrja Hidroekonomike Ibër Lepenc SH.A.*

Për Aktivitetin e Prokurimit: *IL-26-2977-5-2-1*

Sa i përket tenderit për :“ *Renovimi i stacioneve pompike Samadrexhë, Pantinë, Fushticë, Gjurashin, Korroticë, Krashticë (Gllobar)*

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

GEB Sh.p.k & HARST Group SH.P.K.; DACHGroup sh.p.k..
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Brigada 123, pn.
(Adresa)

Suharekë

23000

(Vendi)

(Kodi postar)

+383 49761765

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Genc Bajraktari
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

gebshpk25@gmail.com

(Adresa elektronike)

03.08.2026
(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Njoftimi per kontrate 30.04.2025
Proceverbali i hapjes 12.06.2026
Njoftimi per vendim 26.06.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒

Jo ☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☒

Jo

☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-së.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së- Qëllimi

Neni 6 i LPP-së- Ekonomiciteti dhe efikasiteti

Neni 7 i LPP-së – Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 59 i LPP-së – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 60 i LPP-së – Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 72 i LPP-së – Dokumentacioni dhe informacioni shpeshtë

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar

Me datë 20.07.2026, në lidhje me procedurën tenderuese "Renovimi i stacioneve pompikë Samadrexhë, Pantinë, Fushticë, Gjurashin, Korroticë, Krashticë (Gllobar)", kemi marrë vendim për rekomandimin e Strucon Engineering Shpk & Euro Project Sh.p.k., duke rekomanduar një operator ekonomik me çmim mbi 14,000.00 € më të lartë se oferta jonë. Konsiderojmë se ky veprim bie ndesh me Nenin 1 (Qëllimi) të LPP-së, i cili garanton

përdorimin efikas dhe ekonomik të fondeve publike. Përveq dëmit financiar AK ka bërë dhe shkelje të LPP-së pasi që ke rekomanduar për kontratë një GOE që janë të papërgjegjshëm, kurse neve si GOE me çmim më të ulët dhe të përgjegjshëm na ka eliminuar duke mos respektuar LPP

Arsyet e pretenduara eliminuese nga AK-

Arsyeja 1 eliminuese-

Autoriteti Kontraktues, në Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar të datës 20.07.2026, ka arsyetuar eliminimin e Grupit të Operatorëve Ekonomikë lidhur me certifikimin e Inxhinierit të Mjedisit, duke pretenduar se certifikata e dorëzuar nga GOE nuk përmbush kërkesën e pikës 9.2 të Dosjes së Tenderit, për arsye se sipas Autoritetit Kontraktues kjo pikë kërkon dy certifikime të veçanta, përkatësisht: (i) Vlerësimin e Riskut dhe (ii) Zvogëlimin e Rreziqeve, të lëshuara nga Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME).

Po ashtu, Autoriteti Kontraktues ka arsyetuar se certifikata e dorëzuar nga GOE trajton vetëm fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe se një certifikatë e vetme nuk mund të konsiderohet se përmbush dy kërkesat e përcaktuara në pikën 9.2 të Dosjes së Tenderit.

Përgjigje rreth arsyes eliminuese:

Grupi i Operatorëve Ekonomikë konsideron se ky arsyetim nuk mbështetet në përmbajtjen e Dosjes së Tenderit, nuk është në përputhje me dokumentacionin e procedurës dhe është rezultat i një interpretimi të zgjeruar të bërë gjatë fazës së vlerësimit të ofertave.

Për këtë arsye, në vijim paraqiten faktet dhe argumentet që dëshmojnë se eliminimi i ofertës sonë është i pabazuar në aspektin faktik dhe juridik.

1.1 Dosja e Tenderit nuk kërkon dorëzimin e dy certifikatave të veçanta

Në pikën 9.1 & 9.2 të Dosjes së Tenderit është kërkuar që Inxhinieri i Mjedisit të jetë:

"...i certifikuar për vlerësim të riskut dhe për zvogëlimin e rreziqeve nga AME."

Nga formulimi i kësaj kërkesë rezulton obligimi që eksperti të jetë i certifikuar. Mirëpo, në asnjë pjesë të Dosjes së Tenderit nuk është përcaktuar se ky kriter duhet të dëshmohet përmes dy certifikatave të veçanta.

Po ashtu, në kolonën "Dëshmitë e kërkuara" nuk është kërkuar shprehimisht dorëzimi i dy certifikatave, nuk është përdorur termi "dy certifikata", "certifikata të veçanta", "veçmas" apo ndonjë formulim tjetër që do të krijonte detyrimin për paraqitjen e dy dokumenteve të ndryshme.

Gjithashtu, Dosja e Tenderit nuk përcakton emërtimin e certifikatës që duhet të paraqitet dhe as nuk specifikon programin ose modulën mbi bazën e të cilit duhet të jetë lëshuar ajo certifikatë.

Për rrjedhojë, interpretimi i Autoritetit Kontraktues se pika 9.2 kërkon dy certifikata të ndara nuk buron nga Dosja e Tenderit, por është rezultat i një interpretimi të bërë gjatë fazës së vlerësimit të ofertave.

Në procedurat e prokurimit publik, kriteret e kualifikimit duhet të jenë të qarta, të sakta dhe të njëkuptimta, në mënyrë që çdo operator ekonomik të dijë paraprakisht se çfarë dokumentacioni duhet të dorëzojë. Çdo interpretim që shton kërkesa të reja pas dorëzimit të ofertave bie ndesh me parimet themelore të procedurës së prokurimit.

Në mbështetje të këtij pretendimi bashkëngjiten:

Aneksi 1 – Pika 9.1 & 9.2 e Dosjes së Tenderit Kapaciteti teknik dhe profesional:

		LICENCA A 5. Një Inxhinier I mjedisit së paku 5 vite përvojë pas diplomimi i certifikuar për	
--	--	---	--

B17 Dosja e Tenderit – Pune – Procedurë Hapur

13

Numri i Prokurimit: IL-26-2977-5-2-1 – Titulli: *Renovimi i stacioneve pompikë Samadrexhë, Pantinë, Fushticë, Gjurashin, Korroticë, Krashticë (Gllobar)*

		Ekspert për SSHP-së nga MFPT MPMS, dhe i certifikuar për vlerësim të riskut dhe për zvogëlimin e risqeve nga AME, personi duhet të jetë i certifikuar si Auditor për ISO 14024 – Ekolabeling, Për certifikimin e produkteve dhe proceseve që janë të qëndrueshme mjedisore, duke përfshirë proceset e menaxhimit të mbetjeve. Licence A Staf teknik latues,	
--	--	--	--

Aneksi 2 – Pjesa e Dosjes së Tenderit "Dëshmitë e kërkuara".

		Kontrat 5 7 këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë;
	Stafi profesional 1. Një Inxhinier I diplomuar I ndërtimtarisë - konstruktiv së paku 5 vite përvojë pas diplomimi i certifikuar për Ekspert për SSHP-së, nga MFPT MPMS, I certifikuar per Lead Auditor per 9001. LICENC A, i caktuar me vendim si Menaxher i Projektit! 2. Një Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë -drejtimi hidroteknikë së paku 5 vite përvojë pas diplomimi i certifikuar për Ekspert për SSHP-së nga MFPT MPMS, i cili duhet të posedoj Certifikim për menaxhimin e Projekteve -	Dëshmitë e kerkuara - Lista e nenshkruar dhe e vulosur nga OE per angazhimin e stafit punues prej minimum 20 puneforeve. - Vendim i nenshkruar dhe vulosur nga OE per angazhimin e menaxherit te projektit. CV e menaxherit te projektit e nenshkruar nga vet menaxheri i projektit. kopja e diplomes - CV-të per te gjitha pozitat dhe kopjet e diplomave ose certifikatave Shenim Nje person nuk mund te caktohet ne me shume se nje pozite! Per stafin teknik, nje liste te stafit mbeshtetes te nenshkruar dhe vulosur nga OE.

1.2 Certifikata e paraqitur nga Grupi i Operatorëve Ekonomikë përmbush kërkesën e Dosjes së Tenderit

Grupi i Operatorëve Ekonomikë, në përmbushje të kërkesës së pikës 9.1 & 9.2 të Dosjes së Tenderit, ka paraqitur certifikatën e lëshuar nga Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME) për Inxhinierin e Mjedisit, si dëshmi për përmbushjen e kriterit të kërkuar.

Autoriteti Kontraktues, në arsyetimin e eliminimit, ka vlerësuar se certifikata e paraqitur nuk e përmbush kërkesën e Dosjes së Tenderit, me arsyetimin se ajo është lëshuar në fushën e mbrojtjes nga zjarri.

Ky vlerësim është i pabazuar. Dosja e Tenderit nuk ka përcaktuar se certifikata duhet të ketë një emërtim të caktuar, të jetë e lëshuar sipas një programi të caktuar apo të mbajë një titull të caktuar. Kërkesa e vetme e Autoritetit Kontraktues ka qenë që Inxhinieri i Mjedisit të jetë i certifikuar për vlerësimin e riskut dhe zvogëlimin e rreziqeve nga AME.

Përmbajtja e programit të trajnimit mbi bazën e të cilit është lëshuar certifikata nuk kufizohet vetëm në çështjet e mbrojtjes nga zjarri, por përfshin edhe tema që lidhen drejtpërdrejt me:

- identifikimin dhe vlerësimin e rrezikut;
- analizimin e faktorëve të rrezikut;
- planifikimin e masave parandaluese;
- menaxhimin e rrezikut;
- zvogëlimin dhe kontrollin e rreziqeve;

hartimin e masave mbrojtëse në raste emergjente.

Nga përmbajtja e këtij programi rezulton se certifikata e paraqitur mbulon elementet që lidhen drejtpërdrejt me vlerësimin e riskut dhe zvogëlimin e rreziqeve, të cilat përbëjnë objektin e kërkesës së përcaktuar në pikën 9.1 & 9.2 të Dosjes së Tenderit.

Autoriteti Kontraktues është mbështetur vetëm në emërtimin formal të certifikatës, pa analizuar përmbajtjen e saj dhe pa arsyetuar se përse temat që ajo përfshin nuk e përmbushin kërkesën e Dosjes së Tenderit. Një interpretim i tillë shton një kufizim që nuk është përcaktuar në Dosjen e Tenderit dhe, si i tillë, nuk mund të shërbejë si bazë për eliminimin e ofertës sonë.

Për rrjedhojë, certifikata e paraqitur nga Grupi i Operatorëve Ekonomikë përmbush kërkesën e pikës 9.1 & 9.2 të Dosjes së Tenderit, ndërsa eliminimi i ofertës sonë mbi këtë bazë është i pabazuar.

Në mbështetje të këtij pretendimi bashkëngjiten:

Aneksi 3 – Certifikata e lëshuar nga Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME);



1.3 Autoriteti Kontraktues ka mbajtur qëndrime të ndryshme ndaj të njëjtës dëshmi gjatë së njëjtës procedurë të prokurimit

Një rrethanë me rëndësi të veçantë në këtë procedurë është fakti se e njëjta certifikatë e lëshuar nga Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave (AME), e dorëzuar nga Grupi i Operatorëve Ekonomikë në ofertë, ka qenë objekt vlerësimi si gjatë fazës së vlerësimit fillestar ashtu edhe gjatë fazës së rivlerësimit të ofertave.

Gjatë këtyre fazave, Autoriteti Kontraktues nuk ka ngritur asnjë vërejtje lidhur me përmbushjen e kërkesës së pikës 9.2 të Dosjes së Tenderit dhe, pas rivlerësimit, e ka shpallur Grupin e Operatorëve Ekonomikë si ofertues të suksesshëm.

Vetëm me vendimin e kontestuar, pa ndryshuar Dosja e Tenderit, pa ndryshuar dokumentacioni i ofertës dhe pa paraqitur ndonjë provë ose bazë të re faktike, Autoriteti

Kontraktues ka ndryshuar interpretimin e së njëjtës dëshmi, duke arritur në përfundimin se ajo nuk e përmbush kërkesën e Dosjes së Tenderit.

Një ndryshim i tillë i qëndrimit, mbi të njëjtin dokument dhe brenda të njëjtës procedurë të prokurimit, cenon sigurinë juridike dhe bie ndesh me parimin e vlerësimit të paanshëm, objektiv dhe të qëndrueshëm të ofertave. Autoriteti Kontraktues nuk mund të aplikojë standarde të ndryshme vlerësimi për të njëjtën dëshmi në faza të ndryshme të së njëjtës procedurë.

Dispozitat ligjore relevante

Neni 7 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik – Barazia në trajtim, mosdiskriminimi dhe transparenca. Autoriteti Kontraktues është i obliguar t'i trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe transparente.

Neni 51 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik – Autoriteti Kontraktues duhet t'i specifikojë në njoftimin e kontratës dhe në Dosjen e Tenderit të gjitha kriteret dhe dokumentet e kërkuara; nuk mund të kërkojnë dokumente ose informata që nuk janë përcaktuar në Dosjen e Tenderit.

Neni 52 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik – Gjatë vlerësimit mund të përdoren vetëm kriteret e përcaktuara paraprakisht në Dosjen e Tenderit

-Pretendimi ankimor GOE të rekomanduar:

Qëndrimi i Autoritetit Kontraktues ndaj pretendimeve tona

Në kërkesën për rishqyrtim, Grupi i Operatorëve Ekonomikë ka paraqitur një sërë pretendimesh lidhur me mospërputhjet në ofertën e GOE-së së rekomanduar. Megjithatë, Autoriteti Kontraktues nuk ka shqyrtuar këto pretendime dhe nuk ka dhënë arsyetim konkret për secilin prej tyre, siç kërkohet nga parimet e një vendimmarrjeje të arsyetuar.

Nga dokumentacioni i procedurës rezulton se GOE i rekomanduar është konsideruar operator ekonomik i përgjegjshëm si në vlerësimin fillestar ashtu edhe në rivlerësim. Ndërkohë, pas paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim nga operatori tjetër ekonomik, Autoriteti Kontraktues është përqendruar vetëm në rivlerësimin e ofertës sonë, duke kërkuar sqarime dhe dokumente shtesë, ndërsa pretendimet tona lidhur me ofertën e GOE-së së rekomanduar nuk janë trajtuar fare.

Për rrjedhojë, në vijim paraqiten sërish pretendimet tona, të cilat nuk janë shqyrtuar dhe nuk kanë marrë përgjigje nga Autoriteti Kontraktues.

Pretendimi Ankimor Nr.1 (një) : GOE i rekomanduar nuk ka përmbushur kërkesën e Dosjes së Tenderit për pajisjen lazerike, pasi ka paraqitur pajisje tjetër nga ajo e kërkuar.

Në pikën 9.1 të Dosjes së Tenderit, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë të disponojnë një pajisje lazerike për kontrollimin e nivelit në rrafshin horizontal dhe vertikal, e cila duhet të dëshmohet me dokumentacionin përkatës.

Për të dëshmuar përmbushjen e kësaj kërkesë, GOE i rekomanduar ka paraqitur faturën për pajisjen GOL 26 D + GR 500 + BT. Megjithatë, nga vetë dokumentacioni i paraqitur dhe nga specifikimet zyrtare të prodhuesit rezulton se Bosch GOL 26 D është nivel optik (Optical Level) dhe jo pajisje lazerike.

Rrjedhimisht, dokumentacioni i paraqitur nga GOE i rekomanduar nuk dëshmon posedimin e pajisjes së kërkuar në Dosjen e Tenderit, pasi pajisja e paraqitur nuk është pajisje lazerike për kontrollimin e nivelit në rrafshin horizontal dhe vertikal, por një nivel optik me karakteristika dhe funksion të ndryshëm.

Përkundër mosplotësimit të qartë të kërkesës së përcaktuar në Dosjen e Tenderit nga GOE i rekomanduar, Autoriteti Kontraktues e ka vlerësuar ofertën e tij si të përgjegjshme, ndonëse dokumentacioni i dorëzuar nuk dëshmon përmbushjen e kriterit teknik të kërkuar..

Në mbështetje të këtij pretendimi bashkëngjiten:

Aneksi 1 – Pika 9.1 & 9.2 e Dosjes së Tenderit;

OE duhet te paraqes nje listew te -pajisjeve qe nevojiten pe rprojektin ne fjale (e qu duhet minimalisht te jene); 1. Nje gjenerator minimum 20 KW - deshmi fatura, pagesa dhe foto 2. Nje kamionete - deshmi libreze valide, 3. Kamion me kran per transportin e materialeve - deshmi libreze valide, 4. Skele per pune, 5. prerese per keramike, minimum nje cope, 6. Nje pajisje per thyerje te betonit, 7. Nje pajisje lazerike per kontrollimin e nivelit ne rrafshin horizontal dhe vertikal.

Deshmia dokumentare 1. Lista e pajisjeve e nenshkruar dhe e vulosur nga OE me titull te projektit, 2. Pajisjet te deshmohen me dokumente adekuate te kerkuara per secilen pajisje, 3. Ne rast te huazimit, te deshmohet marreveshja per huazimin e pajisjeve me titull te projektit me dokumentet sipas deshmise 1 dhe 2

Aneksi 2— Fatura e GOE-së së rekomanduar për pajisjen Nivelizus GOL 26 D + GR 500 + BT

BAU Market sh.p.k. Njesia: Bau Market 9

NRB: 601544254, NRB: 810618366, NRTVSH: 330287654

Adresa: Lushnja e Pejës, Fushë Kosovë

Telefon: 038/757 757.

Email: info@baumarket-ks.com



PCB: 1189005057000112 NLB: 4701001012679341 RBKO: 1501090003490521 TED: 2011000123643903 BKT: 1902962406031175 BE:

Blarësi: 3011 - R & Rukollë shpk
NRB/NRB: 810618366, 810618366, 330033671
Vendi: Skenderaj
Tel: 049 283 898

Faturë - Paragon

Faturë sipas paragonit nr. 88900 / 2021
Data: 12.05.2021

Nr.	Shifra	Bar Kodi	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Rabat	Çmimi me Rab.	Vlera Pa Tvsh	Tvsh %	Vlera Me Tvsh
1	21154	3165140572852	Nivëlizues GOL20 D + GR 500 + BT	copë	1.00	309.000	8.00	284.28	240.92	18.00	284.28
									€240.92		284.28

Koment:

ra E Pagesës

NE TE GATSHME

Dorëzoi:

Vlera

284.28

Vlera e rabatit: 24.72

Norma

18.00 %

Vlera e tatueshme

240.92

TVSH

43.36

Për Pagesë:

284.28€

Pranoi:

Kyrolli E

1/1

Aneksi 3 – Specifikimi zyrtar i prodhuesit Bosch, ku modeli **Bosch GOL 26 D** identifikohet si **Optical Level**.



BOSCH
Invented for life

Product data sheet

Power tools for trade & industry

Optical Level

PRO GOL 26 D



Extremely robust – ideal for outdoor use

The most important data

Unit of measure	360 degrees
Magnification	26 x
Accuracy	± 1.6 mm at 30 m

Part Number 0 601 068 002

Technical data

Technical data

Unit of measure	360 degrees
Magnification	26 x
Accuracy	± 1.6 mm at 30 m
Working range	100 m
Dust and splash protection	IP 54
Tripod thread	5/8"
Operating temperature	-10 – 50 °C
Storage temperature	-20 – 70 °C
Weight, approx.	1.5 kg



BOSCH GOL 26D+BT 160+GR 500 OPTICAL LEVELLER 100M – L192

[Visit >](#)

Pretendimi Ankimor Nr. 2 (dy): GOE i rekomanduar nuk ka dëshmuar të drejtën e përdorimit të pajisjes Topcon sipas kërkesës së Dosjes së Tenderit.

Sipas pikës 9.1 të Dosjes së Tenderit, Autoriteti Kontraktues ka kërkuar që në rast se pajisjet nuk janë në pronësi të operatorit ekonomik, përdorimi i tyre të dëshmohet përmes marrëveshjes për huazimin e pajisjeve me titull të projektit, së bashku me dokumentacionin e kërkuar për pajisjen.

GOE i rekomanduar, për të dëshmuar pajisjen Topcon, ka paraqitur faturën nr. 12/2026, nga e cila rezulton se blerësi është DUA ARCH SH.P.K., subjekt i cili nuk është pjesë e Grupit të Operatorëve Ekonomikë.

Përkundër faktit se pajisja nuk është në pronësi të GOE-së së rekomanduar, në ofertë nuk është paraqitur asnjë marrëveshje për huazimin e kësaj pajisjeje me DUA ARCH SH.P.K., siç është kërkuar shprehimisht nga Dosja e Tenderit.

Për rrjedhojë, GOE i rekomanduar nuk ka dëshmuar posedimin apo të drejtën e përdorimit të kësaj pajisjeje në përputhje me kërkesat e Dosjes së Tenderit, ndërsa Autoriteti Kontraktues, përkundër kësaj mangësie, e ka konsideruar ofertën si të përgjegjshme.

Aneksi 1 – Pika 9.1 e Dosjes së Tenderit;

OE duhet të paraqes një listë të pajisjeve që nevojiten për projektin në fjalë (e quajturë minimalisht të jenë); 1. Një gjenerator minimum 20 KW - dëshmi fatura, pagesa dhe foto 2. Një kamionetë - dëshmia libere valide, 3. Kamion me kran për transportin e materialeve - dëshmia libere valide, 4. Skele për punë, 5. prerese për keramike, minimum një cope, 6. Një pajisje për thyerje të betonit, 7. Një pajisje lazerike për kontrollimin e nivelit në rrafshin horizontal dhe vertikal.

Dëshmia dokumentare 1. Lista e pajisjeve të nënshkruar dhe të vëlosur nga OE me titull të projektit, 2. Pajisjet të dëshmohen me dokumente adekuate të kërkuara për secilën pajisje, 3. Në rast të huazimit, të dëshmohet marrëveshja për huazimin e pajisjeve me titull të projektit me dokumentet sipas dëshmive 1 dhe 2

Aneksi 2 – Fatura për pajisjen Topcon, nga e cila rezulton se blerësi është DUA ARCH SH.P.K.

BLERESI:		SHITESI:	
DUA ARCH SH.P.K.		NEXHAT SINANI, B.I.	
Numri Unik Identifikimit : 811431139		Numri Unik Identifikimit : 811289091	
SHESHI "KADRI ZEKA", p.n.		Fshati Veleçincë	
GJILAN		GJILAN	

FATURA Nr. 12 / 2026

RAIFFEISEN BANK J.S.C. - GJILAN

Emri i llogarisë : NEXHAT SINANI, B.I.

RAIFFEISEN BANK J.S.C. Numri i llogarisë : 1507001008337427

Data : 06.05.2026

Nr. Nr.	PËRSHKRIMI	Sasia	Cmimi / €	SHUMA / €
1	APARAT PËR MATJE, NIVILIZIM, NDËRTIM TOPCON	1	300.00	300.00
Me fjalë : (Treqinda € / 0.00 cent)				
Afati i pagesës 1 ditë nga data e pranimit, me rastin e pagesës në bankë shëno numrin e dokumentit.				
TOTALI PAGESËS:				300.00

Gjilan
Më : 06.05.2026



NEXHAT SINANI, B.I.
(Gënjehkrimi)
(personit të autorizuar)

Pretendimi Ankimor Nr. 3 (tre): Marrëveshja e konsorciumit e GOE-së së rekomanduar është e pavlefshme për shkak të mungesës së nënshkrimit dhe vulës së personit të autorizuar.

GOE i rekomanduar ka paraqitur marrëveshjen e konsorciumit, e cila nuk është e vlefshme, pasi në faqen e dytë të saj personi i caktuar si person i autorizuar nuk e ka nënshkruar dhe vulosur marrëveshjen. Për pasojë, personi i autorizuar nuk ka pranuar përgjegjësitë dhe autorizimet e përcaktuara në këtë marrëveshje, ndërsa GOE nuk ka dëshmuar vlefshmërinë e përfaqësimit të tij. Si rrjedhojë, marrëveshja e konsorciumit nuk përmbush kërkesat e Dosjes së Tenderit dhe nuk mund të konsiderohet dokument i vlefshëm për përcaktimin e personit të autorizuar të konsorciumit.

...në përputhje me nenin 99.2 të LPP-së.

Emri i Operatorit Ekonomik (lider)	"STRUCON ENGINEERING" SH.P.K
Emri Mbiemri	GËZIM BICI, Drejtor
Data/ Nënshkrimi/ Vula	09.06.2026
Anëtarët e tjerë të grupit:	
Emri i Operatorit Ekonomik (anëtar)	"EURO PROJECT" SH.P.K
Emri Mbiemri	JUSUF VELIU, Drejtor
Data/ Nënshkrimi/ Vula	09.06.2026
Shtu sipas nevojës	
Emri Mbiemri (Përfaqësuesi i autorizuar)	GËZIM BICI
Data/Nënshkrimi / Vula	09.06.2026



Pretendimi Ankimor Nr. 4 (katër): GOE i rekomanduar ka paraqitur deklarata të pavlefshme për përmbushjen e specifikimeve teknike dhe garancionin e punimeve.

Në Dosjen e Tenderit është kërkuar dorëzimi i Deklaratës për përmbushjen e specifikimeve teknike dhe Deklaratës për garancionin e punimeve. GOE i rekomanduar ka paraqitur këto deklarata, mirëpo ato janë të pavlefshme, pasi janë vulosur vetëm nga njëri anëtar i konsorciumit, ndërsa anëtari tjetër nuk i ka nënshkruar dhe vulosur ato. Për pasojë, njëri anëtar i konsorciumit nuk ka pranuar përgjegjësinë lidhur me përmbushjen e specifikimeve teknike dhe garancionin e punimeve, duke bërë që deklaratat të mos

përfaqësojnë vullnetin dhe përgjegjësinë e të gjithë anëtarëve të konsorciumit. Përkundër kësaj, Autoriteti Kontraktues i ka pranuar këto deklarata si të vlefshme.

Pretendimi ankimor 5 (pesë): GOE i rekomanduar nuk ka dëshmuar përmbushjen e kriterit të Dosjes së Tenderit lidhur me angazhimin e një (1) latuesi.

Sipas pikës 9.1 dhe 9.2 të Dosjes së Tenderit – Kapaciteti teknik dhe profesional, është kërkuar shprehimisht angazhimi i një (1) latuesi. GOE i rekomanduar nuk ka dëshmuar përmbushjen e kësaj kërkesë, pasi dokumentacioni i paraqitur nuk provon se personi i propozuar posedon kualifikimin e kërkuar për pozitën e latuesit. Përkundër kësaj, Autoriteti Kontraktues e ka konsideruar kriterin të përmbushur dhe e ka vlerësuar ofertën e GOE-së si të përgjegjshme, në kundërshtim me pikën 9.1 dhe 9.2 të Dosjes së Tenderit

Kërkojmë nga ju, si AK, që kjo lëndë të kthehet në rivlerësim dhe ne, si GOE i vetëm i përgjegjshëm dhe me çmimin më të ulët, të shpërblehemi me kontratë, pasi konsiderojmë se GOE i rekomanduar përveq që është me çmim më të lartë i njëjti është dhe i papërgjegjshëm.

Prandaj, vlerësojmë se nga ana e AK janë bërë shkelje të dispozitave ligjore të LPP-së, të cilat i kemi theksuar më lart, dhe kërkojmë që lënda të kthehet në rivlerësim.

VENDIM

APROVOHET Kërkesa për rishqyrtim e GOE GEB Shpk & HARST Group SH.P.K.;
DACHGroup shpk si e bazuar

ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM**,

DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Ne konsiderojmë që AK na ka bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim, si dhe damtime tjera në fitimin e pritur, vlerë të referencave, imazh dhe dëmtime tjera që mund të ndodhin në vlerë prej 333,388.24 Euro

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t’ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t’ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*